



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**  
Kabineti i Ministres  
Kabinet Ministra  
Minister's Office

Nr.124/2023  
Datë:23.06.2023

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), bazuar në nenin 8 ( paragrafi 1.4 ) nenin 14 (paragrafi 1 nen paragrafi 1,8 ) të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe duke u mbështetur ne nenin 4 te Ligjit Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, Rregulloren Nr. 11/2022 për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes se trashëgimisë kulturore për mbrojtje si dhe duke marre për bazë propozimin e Kryetares së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore në lidhje me propozimet e shqyrtuara dhe të rekomanduara për përfshirje të aseteve të trashëgimisë kulturore në Listën për Mbrojtje të Përhershme, mori këtë:

### V E N D I M

1. Aprovohet Lista e aseteve të Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të përhershme, sipas propozimeve të shqyrtuara nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore për përfshirje të këtyre aseteve në Listën e aseteve me status të mbrojtjes së përhershme.
2. Lista e aprovuar si në pikën një ( 1 ) te këtij Vendimi, përfshin 18 ( tetëmbëdhjetë) asete të trashëgimisë kulturore si në vijim:
  - 2.1.Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”;
  - 2.2.Biblioteka “Hivzi Sylejmani”;
  - 2.3.Kulla e Sahatit;
  - 2.4.Muzeu i Kosovës;
  - 2.5.Shtëpi Banimi e Familjës së Hynilerëve;
  - 2.6. Xhamia e Çarshisë;
  - 2.7. Xhamia e Jashar Pashës;
  - 2.8. Kino Lumbardhi;

- 2.9. Kërëk Xhamia - Namazxhah;
- 2.10. Kompleksi i banimit i familjes Hadro;
- 2.11. Shtëpia e Muhamer Shabanit;
- 2.12. Kompleksi Memorial “Adem Jashari” ;
- 2.13. Hamami i Vjetër;
- 2.14. Kompleksi i Kullës së Isë Boletinit;
- 2.15. Konaku i Tahir Beut;
- 2.16. Konaku i Kasapollëve;
- 2.17. Kulla e Sahatit;
- 2.18. Lokaliteti Arkeologjik “Vendenis”.

3. Këtij Vendimi i bashkëngjitet edhe Lista origjinale e cila konsiderohet pjesë përbërëse e këtij Vendimi .
4. Ky vendim hynë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

*Vendimi i dërgohet:*

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Komunave përkatëse;
- Inspektoratit për Trashëgimi Kulturore;
- Departamentit për Trashëgimi Kulturore;
- Institucioneve të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK - ve përkatëse;
- Agjencionit Kadastral të Kosovës
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.

Hajrulla Çeku  
Ministër

